

Qyteti im

→

falas



**Bashki – Komunitet vendosin
së bashku për investimet 2009**

Bashkia stimulon nxënësit më të mirë

**Java e kulturës, një javë ndryshe
nga të tjerat**



**KORÇA KU
DUA TE JETOJ**



Java e kulturës, një javë ndryshe nga të tjerat

21 – 29 SHTATOR 2008

Bashkia e qytetit të Korçës në datat 21 deri 29 shtator organizoi

“Javën e Kulturës 2008”. Me sloganin “Një javë ndryshe nga të tjerat!”, për nëntë ditë me radhë, kalendari i aktiviteteve të Javës së Kulturës, ishte një pasqyrë e plotë e vlerave më të spikatura të trashëgimisë kulturore të trevës së Korçës, prioritet i Bashkisë për zhvillimin e turizmit kulturor.

Gjatë kësaj jave, Bashkia e Korçës në bashkëpunim me Qendrën Kulturore “V.Mio”, Bibliotekën e qytetit “Th.Mitko”, Teatrin “A.Z.Çajupi” dhe muzetë e qytetit, i solli këto vlera më pranë qytetarëve përmes

Ekspozitë retrospektivë e skulptorit Pirro Dollaku tek Qendra Kulturore “V. Mio”

Ekspozita retrospektivë e skulptorit Pirro Dollaku, ishte e para që çeli kalendarin e aktiviteteve të Javës së Kulturës. Skulptori është autor i disa veprave në qytetin e Korçës si “Busti i Skënderbeut” i cili ndodhet në sheshi para Stadiumit që mban të njëjtin emër, si dhe Monumenti “Partizani” tek Varrezat e Dëshmorëve.

Ekspozitë multimediale tek Muzeu Kombëtar i Arsimit “MËSONJËTORJA E PARË SHQIPE”

Ekspozita muldimediale, tërësisht e veçantë në llojin e vet, me autorë, tre të rinj të talentuar Donika Çina, Bledi Kita dhe Entela Hoxha, erdhi për artdashësit me një frymë mjaft bashkëkohore. Artistët e rinj prezantuan foto, mix-video, video-instalation e aplikacione, me gjuhën e një arti tërësisht abstraksionist e modern.

Ekspozitë multimediale

Donika Çina "Jashtë Pasqyrës" Video Installation
"The Girl" Video performance
"Frymë" Multimedia

Bledi Kita "Lartësia" Lapsa me Najra në leter

Entela Hoxha "Patitull" Video performance
"Patitull" Video
"Kukulla prej duri" Video
"Patitull" Fotografji

NË Galerinë e "Mësonjëtores së parë shqipe"
22 Shtator 2008
Ora 19:30
Mbeshtetur nga Bashkia e Korçës

Komedia “Ju ftojmë në dasmën e babait” tek Teatri “Andon Zako Çajupi”

Drama “Ju ftojmë në dasmën e babait” trajtoi situata komike të një familje të varfër, ku pamundësia ekonomike e detyroi këtë familje të bëjë gjithçka për të mbijetuar.

Komedia interpretohet nga trupa e teatrit të Korçës me pjesëmarrjen ekskluzive të humoristit durrsak Muharrem Hoxha.



“Rebelim poetik” – Promovim libri tek Biblioteka “Thimi Mitko”

“Rebelim poetik” është titulluar Antologjia poetike e disa autorëve, e cila është promovuar nën kujdesin e Klubit të Shkrimtarëve “Bota e re”. Antologjia është një përmbledhje poezish nga 9 autorë korçarë, të cilët janë prej vitesh anëtarë të Klubit të Shkrimtarëve “Bota e re”, por për herë të parë dalin së bashku me një përmbledhje të krijimtarisë së tyre poetike.

Festivali i sazeve tek Teatri “Andon Zako Çajupi”

Këtë vit, Festivali i Sazeve dhe Orkestrinave Popullore shënoi edicionin e tij të gjashtë me mbështetjen e Bashkisë Korçë, Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sporteve dhe Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike. Në të morën pjesë 7 grupet e sazeve të jugut të Shqipërisë, si dhe grupi i Sazeve të Strugës. Juria e festivalit shpalli grupin më të mirë grupin sazeve të Korçës, ndërsa Çimi “Laver Bariu” për interpretuesin më të mirë, i takoi Sadik Zeqirit, Karinetist i Sazeve të Përmetit. Ndërkohë Aleks Xhelili vlerësohet me Çmimin e Karrierës.

Dita Ndërkombëtare e Turizmit

Në datën 27 Shtator, në Ditën Ndërkombëtare të Turizmit, Bashkia Korçë me mbështetjen e organizatës hollandeze SNV, filloi procesin e marrjes së mendimit qytetar për Draft Planin e Veprimit për Zhvillimin e Turizmit në qytetin e Korçës. Ky Draft Plan është hartuar në Prill të këtij viti nga Komiteti i Zhvillimit të Turizmit në qytetin e Korçës që përbëhet nga aktorë të interesuar në fushën e turizmit. Që në Prill e deri tani, në takimet e ndryshme të zhvilluara nga Komiteti ky draft është riparë e rivlerësuar disa herë. Ndërkohë përgjatë një jave nga data 27 Shtator deri në 4 Tetor, tek Muzeu Kombëtar i Arsimit “Mësonjëtorja e parë shqipe”, plani do të jetë i hapur për mendimet dhe sugjerimet e qytetarëve dhe palëve të interesuara, të cilët do të kenë mundësi të kenë një përmbledhje të draftit dhe nëpërmjet pyetsorëve të përgatitur do të japin opinionin e tyre. Pas marrjes së mendimit qytetar Planin për Zhvillimin e Turizmit do të kalojë për miratim nga Këshilli Bashkiak.



Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore

Java e Kulturës u mbyll ditën e hënë, në datën 29 shtator, në Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, në të cilën të gjitha muzeumet e qytetit kanë qenë të hapura për vizitorët, nga ora 9:00 – 21:00. Ndërkohë, në Bibliotekën “Th. Mitko” të qytetit qëndroi e hapur për disa orë, një Ekspozitë e shtypit shqiptar.

Për herë të parë , Festa e Lakrorit

Ditën e diel, tek Parku Rinia, u organizua për herë të parë Festa e Lakrorit. Një festë e re dhe veçantë për qytetin dhe për të gjithë ata që e shijuan. Amvisat korçare, ato të Polenës si dhe të Dardhës, gatuan me mjeshtëri lakrorin me dy petë si dhe produkte të tjera brumi. Pjesëmarrja e “Greal” me freskinë e dhallës, i dha akoma më tepër shije festës. E veçanta, ishte gatimi në moment i lakrorëve si dhe pjekja e tyre në saç. Festa u pasurua me performimin e këngëtares Laxarela si dhe vallet e Ansambllit të Qendrës Kulturore “V. Mio”. Festa solli të dielën në Park, jo vetëm qytetarë korçarë, apo të rrethinave, por edhe qytetarë të Tiranës dhe Durrësit, kureshtarë për këtë festë të re të qytetit. Organizimi i kësaj feste synon, veç gjallërimit të jetës në qytet dhe zhvillimit të turizmit edhe ruajtjen e traditës korçare të gatimit të lakrorit.





Buxhetimi me pjesëmarrje

Bashkia Korçë, në kuadër të programit “Bashkia për Qytetarët”, në datat 22 shtator deri në 2 tetor 2008, zhvilloi procesin e përgatitjes së Projektbuxhetit për Investimet e vitit 2009.

Ashtu si vitin e kaluar, metoda e përdorur ishte ajo e “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, i cili është një proces renditjeje prioritetesh dhe vendimmarrjeje i përbashkët, përmes së cilit qytetarët dhe pushteti vendor vendosin bashkarisht në lidhje me akordimin përfundimtar të investimeve publike.

Gjatë 8 ditëve, qytetarët e Korçës, të grupuar sipas lagjeve dhe Rajoneve Administrative, zhvilluan takime të hapura, në të cilat patën mundësinë të diskutojnë së bashku me Kryetarin e Bashkisë Niko Peleshi dhe përfaqësues nga institucioni i Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Ndërmarrja e Ujësllëllës –Kanalizimeve e të tjerë, mbi Projektbuxhetin e Investimeve për vitin 2009, duke konfirmuar angazhimin e tyre në projektet komunitare.

Bashkia Korçë e konsideron me rëndësi përfshirjen sa më të madhe të qytetarëve në këtë proces, me synim hedhjen e bazave për qëndrueshmërinë e tij. Kjo pasi ngritja e prioriteteve sipas kërkesave të qytetarëve do të çonte aty ku duhet investimet e bashkisë.

Përgjatë këtyre ditëve, Kryebashkiaku Peleshi ndau me qytetarët probleme, nevojat, projekte konkrete për zhvillimin e qytetit duke iu përgjigjur pyetjeve të ngritura.

Pas renditjes së propozimeve, qytetarët votuan për tre prioritete, të cilat ata i konsideruan më të rëndësishmet në lagjen e tyre.

Në një hap të dytë, do të bëhet listimi i prioriteteve të votuara, nga ku me pas, procesi do të kalojë në vlerësimin e komisionit, në përbërje të të cilit krahas specialistëve të fushës do të ketë edhe përfaqësues të lagjeve të zgjedhur nga vetë qytetarët.

Në fund, do të jetë Këshilli Bashkiak, i cili do t'i japë OK përfundimtar listës së objekteve, të cilat do të investohen nga Bashkia e qytetit gjatë vitit 2009.

“Komuniteti në veprim”, bashkë për vazhdimësinë e projekteve tona

Në takimet e Buxhetimit me pjesëmarrje, u prezantua edhe iniciativa e re e Bashkisë Korçë, “Komuniteti në veprim”, me slogenin “Bashkë për vazhdimësinë e projekteve tona”.

Kjo iniciativë parashikon përfshirjen e komunitetit në rigjenerimin e sipërfaqeve të gjelbra dhe hapësirave ndërmjet pallateve, e cila ka mjaft rëndësi për nxitjen e iniciativave dhe sigurimin e vazhdimësisë e jetëgjatësisë së projekteve në komunitet.

Ajo pritet të ketë mjaft impakt në komunitet, në kushtet kur ekziston një planifikim urban për sistemimin e shesheve mes pallateve dhe projekte konkrete për sipërfaqe të gjelbra e kënde lojërash, si dhe ajo çka është më e rëndësishme, dëshira e banorëve për një mjedis më të mirë. Kontributi financiar i komunitetit për këto projekte do të të zërë vetëm 10% të vlerës së projektit, ndërkohë që pjesa tjetër prej 90%, do të mbulohet nga investimet e Bashkisë. Parashikohet që të ngrihen grupe të posaçme në komunitet, të cilat do të menaxhojnë procesin.





ProCredit Bank

Albania



ProRinovim

Deri në 750.000 lek nuk kërkohet asnjë garanci

Paratë bëhen tuajat brenda 3 ditësh

Për shumat deri në 6.000.000 lek, hipoteka nuk është kusht


Kredia për Rinovimin e shtëpisë suaj!

ProCredit Bank, Gjithmonë pranë meje!



Sondazhi për Zonën Këmbësore Pro 73.63% e qytetarëve


Kthimi i Bulevard “Shën Gjergjit” në Zonë Këmbësore mbetet një nga prioritetet më të mëdha të investimeve të Bashkisë Korçë, aq më tepër kur kjo ide ka siguruar tashmë edhe mbështetjen e qytetarëve të Korçës. Këtë e vërtetojnë edhe rezultatet e sondazhit të bërë me këtë rast, ku 73.63 % e qytetarëve i janë përgjigjur pro këtij pprojehti, ndërkohë që vetëm 4.14 % i janë përgjigjur negativisht.



Kategoria	nr	%
Aspak	20	4.14
Pak	100	20.53
Shumë	340	73.63
Pa përgjigje	8	1.70

Kanalizimet, Korça siguron të gjithë investimin

Nënshkruhet marrëveshja me Bankën Gjermane të Investimeve KFW për financimin e fazës së tretë të kanalizimeve me vlerën 15 milion euro. Në fazën e tretë rrjeti i ri i kanalizimeve do të shtrihet në Lagjet 1,2 dhe 3 të qytetit i cili parashikon edhe rikonstruksionin e të gjitha rrugëve në to. Me këtë financim, qyteti i Korçës rinovon të gjithë sipërfaqen e tij të banuar me sistemin e ri të kanalizimeve. Në pranverën që vjen do të çelët tenderi që do të shpallë kompaninë fituese.



Hapet e para “Qendër Komunitare për të Moshuarit” në Korçë

Bashkia e qytetit hapi të parën “Qendër Komunitare për të Moshuarit” në Korçë.

Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi, ka qënë i pari që e vizitoi këtë qendër duke u uruar mirëseardhjen 35 banorëve të saj duke u premtuar mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm për ta edhe në të ardhmen.

Hapja e Qendrës Komunitare për të Moshuarit ka qënë një nga projektet më prioritare të Bashkisë së qytetit në kuadër të programit “Qyteti Social”, i cili ka për qëllim përkrahjen e grupeve në nevojë. Kjo është një qendër ditore, e cila ndodhet në një ambient mjaft komod në Lagjen 12, në afërsi të qendrës së qytetit dhe do të trajtojë si fillim 35 të moshuar të vetmuar. Qendra ofron ambient familjar, leximin e shtypit të ditës, kafën e mëngjesit falas, si dhe shërbim mjekësor e psikologjik gjithashtu falas. Për më tepër kjo qendër do të ofrojë edhe aktivitete argëtuese apo ekskursione të ndryshme.

Ngritja e kësaj qendre është iniciativë e Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, dega Korçë si dhe me mbështetjen e Bankës Popullore.

Gjatë 2009-ës do të synohet, rritja e numrit të këtyre qendrave, në mënyrë që ato t’u shërbejnë edhe më mire nevojave të moshës së tretë.

shës së tretë



Qyteti Social



Kite shkollore për fëmijët

“Kite shkollore për fëmijët”, është projekti më i fundit me të cilin Bashkia e qytetit të Korçës, me rastin e fillimit të Vitit të Ri Shkollor 2008-2009, iu vjen në ndihmë fëmijëve jetime dhe fëmijëve në nevojë.

Projekti “Kite shkollore për fëmijët” është pjesë e Programit të Bashkisë së Korçës “Qyteti social” i cili synon t’u gjendet më pranë shtresave në nevojë.

Përfitues të tij u bënë 80 fëmijë, prej të cilëve 50 fëmijë jetimë (pa prindër ose me një prind) dhe 30 të tjerë fëmijë në nevojë, pra fëmijë që jetojnë në familje me kushte të vështira ekonomike. Përzgjedhja e fëmijëve ishte rezultat i bashkëpunimit mes Zyrës për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë Korçë, Organizatës “Terre des Hommes” dhe Shoqatës së Fëmijëve Jetimë.

Fëmijët e pranishëm i përshëndeti Nënkryetari i Bashkisë së Korçës, Sotiraq Filo. Ai u uroi suksese dhe një vijueshmëri maksimale të gjithë fëmijëve gjatë këtij viti shkollor, duke i inkurajuar se Bashkia Korçë do të shtojë programet e saj në mbështetje të këtij Target-grupi.

Projekti u mbështet financiarisht nga Bashkia Korçë dhe Pro Credit Bank.

Suksese dhe një vit të mbarë shkollor!

Nga Shkolla "Raqi Qirinxhi" Kryebashkiaku i Korçës Niko Peleshi uron të gjithë nxënësit për Vitin e Ri Shkollor 2008-2009

"Ne duhet të realizojmë çdo ditë, vlera arsimore dhe edukative me moton: Shkolla e mesme nuk është një orë dhe një vend, por një pasuri e madhe mendore për nxënësit, prindërit dhe mbarë shoqërinë".

Në këtë mënyrë u uroi mirëseardhjen nxënësve të Shkollës së Mesme të Përgjithshme "Raqi Qirinxhi", Drejtori i Shkollës Gjergji Çikopani, në ditën e parë të vitit të ri akademik

2008-2009. Në ceremoninë e rastit ishte prezent Kryebashkiaku i Korçës Niko Peleshi, i cili zgjodhi shkollën ku ai ka qenë vetë nxënës, për t'u uruar suksese të gjithë nxënësve të qytetit të Korçës.

Arsyeja tjetër përse Kryetari Peleshi zgjodhi këtë shkollë për të qenë prezent në ditën e parë të fillimit të saj, ishte përirrimi i fushës së tenisit. Ngritja e kësaj fushe e mundësuar nga Bashkia Korçë dhe Drejtoria Arsimore Rajonale, me vlerën prej afro 30 000 euro, do të hyjë në historinë e shkollës dhe të qytetit si e para fushë tenisi në qytet mbas mëse gjysëm shekulli.

Bashkia e Korçës ka nw programet e veta mbështetjen e të rinjve, duke synuar stimulimin e tyre për rezultate më të mira, në mënyrë që të krijohet një gjeneratë specialistësh të aftë, të cilët do të jenë në gjendje të projektojnë të ardhmen.

Në përputhje me këtë vizion, Bashkia e qytetit këtë vit mbështeti moralisht dhe materialisht 25 maturantët më të mirë, duke i dhuruar secilit nga një kompjuter. Njëkohësisht nxënësit më të mirë të këtij viti do të marrin nga një bursë mujore nga fondi i Bashkisë Korçë.

Projektet e bashkisë në mbështetje të nxënësve nuk mbarojnë këtu. Duke filluar nga muaji i ardhshëm, tre shkolla në qytet duke përfshirë edhe Shkollën "Raqi Qirinxhi", do të pajisen me internet falas, 24 orë në ditë, duke shënuar një përmirësim të dukshëm në infrastrukturën e teknologjive të reja të informacionit dhe rrjedhimisht të mësimdhënies në shkollat më të rëndësishme të qytetit të Korçës.

Suksese dhe një vit të mbarë shkollor për të gjithë !



Bashkia dhuron kompjutera për maturantët e shkëlqyer

Bashkia Korçë u dhuroi kompjutera maturantëve më të mirë të vitit shkollor 2007-2008. Kanë qenë 25 maturantë të dalluar të shkollave të mesme të qytetit të cilët përfituan secili nga një kompjuter me një fond nga buxheti i Bashkisë Korçë.

Kryetari i Bashkisë Korçë Niko Peleshi i pranishëm në ceremoni, u dha çertifikata vlerësimi maturantëve të pranishëm duke uruar që kur të mbarojnë studimet ta konsiderojnë Korçën si një opsion për tu kthyer e për të punuar këtu, për ta bërë qytetin e Korçës më tërheqës, me një të ardhme më të mirë. Projekti ka filluar vitin e kaluar me dhurimin e 14 kompjuterave dhe synon të vazhdojë duke shtuar nga viti në vit numrin e kompjuterave që do të dhurohen.

Nëpërmjet këtij projekti Bashkia Korçë synon stimulimin e nxënësve maturantë me rezultatet më të mira dhe përhapjen e teknologjive të reja të informacionit. Brenda këtij viti, Bashkia Korçë do të mbështesë internetin falas në të paktën tre shkolla të qytetit. Duke pasur këtë optikë, Bashkia Korçë nw vazhdim do të shtojë shërbimet e veta ndaj qytetarëve. Kështu shumë shpejt, qytetarët e Korçës do të kenë mundësinë që t'i marrin shërbimet e Bashkisë falas, çdo ditë në 24 orë.



Starton projekti “Artistët e vegjël”

Bashkia e Korçës ka çelur kurset 4-mujore për të gjithë fëmijët e moshës nga 6 deri 14 vjeç, të cilët janë të apasionuar pas vizatimit, poçerisë, kitarës, baletit dhe fotografisë. Projekti i cili mban emrin “Artistët e vegjël”, është pjesë e Programit të Bashkisë “Qyteti për fëmijët” dhe synon mësimin e arteve të ndryshme mbi baza profesionale, përfshirjen e të talentuarve dhe të apasionuarve në to, si dhe rigjallërimin e traditës dhe angazhimin e fëmijëve në tematika të panjohura më parë.

Çelja e Projektit “Artistët e vegjël” u prezantua për të gjithë fëmijët e prindërit në mjediset e Qendrës Kulturore “V.Mio”. Në të ishin prezent Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi si dhe Drejtori i Raiffeisen Bank, Erjon Daçolli. Në fjalën përshëndetëse, Kryetari i Bashkisë Korçë Niko Peleshi, ndër të tjera nënvizoi se nëpërmjet këtij programi, Bashkia synon të përgatisë brezin e ri, duke zhvilluar e rigjallëruar disa vlera të hershme artistike të qytetit të Korçës. Në vijim të rivlerësimit të traditës, Kryebashkiaku Peleshi, gjeti rastin të prezantojë para auditorit projektin më të ri të Bashkisë Korçë: Një nga sheshet e qytetit po projektohet në formën e mandolinës dhe synohet që ky shesh të mbajë emrin e serenatës korçare, një nga simbolet më të spikatur identifikues të qytetit të Korçës.

Edhe Erjon Daçolli, me cilësinë e Drejtorit të Bankës Raiffeisen që ka mbështetur këto kurse, u ka uruar fëmijëve pjesëmarrës suksese. Motoja e Bankës Raiffeisen është: “Të ndihmojmë ata që ndihmojnë veten”. Ai e ka siguruar Kryetarin e Bashkisë z. Peleshi se mbështetja e tij në projekte që nxitin dhe zhvillojnë talentet, do të jetë e vazhdueshme.

Kurset janë pa pagesë dhe me një personel të kualifikuar. Ato kanë filluar në datë 8 shtator dhe do të shtrihen deri në fund të muajit dhjetor të këtij viti. Kurset e vizatimit, kitarës dhe fotografisë do të zhvillohen tek Qendra Kulturore “Vangjush Mio”. Kursi i baletit tek “Have a Dream Academy” tek Rr. “Niko Kovaçi” (ish dritat e verdha). Ndërkohë Kursi i poçerisë do të zhvillohet tek punishtja e z. Vasillaq Kolevica në Rrugën Korçë – Drenovë (përballë Pularisë “Shehu”). Në fund të kurseve fëmijët do të pajisen me certifikatë.



22 shtator Dita Ndërkombëtare pa Makina



Në paraditen e datës 22 shtator, me moton “Në qytet pa makinën time”, Bulevard “Shën Gjergji” u kthye për disa orë në hapësirën e pastër të lëvizjes së kalimtarëve dhe biçikletave për të përcjellë mesazhin e ndërgjegjësimi të të rinjve dhe komunitetit në lidhje me rëndësinë jetike të një ajri të pastër.

Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rationale, Qendrën Kulturore të Fëmijëve, Drejtorinë e SHëndetit Publik dhe me mbështetjen financiare të firmës të pastrimit “Korsel”, nxënësit e shkollave të ndryshme të qytetit të Korçës lëvizën me biçikleta dhe patina, ndërkohë që në trotuarin përgjatë bulevardit u çel një ek-

spozihtë me piktura me këtë temë si dhe u dha një koncert nga nxënësit e Shkollës së Muzikës dhe Banda e qytetit.

Sensibilizimi i komunitetit për reduktimin e përdorimit të makinave si edhe ndërtimi i një zone këmbësore, që është një ndër prioritetet e investimeve të Bashkisë Korçë në infrastrukturë pritet të sjellë efekte pozitive në drejtim të reduktimit të ndotjes së mjedisit në qytetin e Korçës.



Supplement



**ANDROMAQI
GJERGJI**
tek "Qyteti im"

Andromaqi Gjergji tek "Qyteti im"

"E tërë jeta e një populli përshkruhet nga arti"

Shkencëtarja korçare që ia kushtoi jetën artit të popullit të saj

Andromaqi Gjergji është një nga emrat më të spikatur në fushën e etnografisë dhe artit popullor. Ajo është anëtarja e parë femër e Akademisë të Shkencave të Shqipërisë dhe padyshim një vlerë kulminante e shkencës shqiptare dhe një ndër më të shquarat në etnologjinë europiane dhe botërore.

U lind në Korçë më 20 maj 1928. U diplomua në Fakultetin e Histori –Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Doktoroi në shkencat historike (1980) dhe në vitin 1994 mori titullin "Profesor". Bibliografia e shkrimeve të saj numuron rreth 200 artikuj studimorë shkencorë të botuara brenda dhe jashtë vendit. Kontributi i saj është veçanërisht i rëndësishëm në zbuluesën e zanafillës sonë kombëtare në qarkun e madh të civilizimeve të tjera ballkanike dhe europiane. Vlerat e punës të saj shkencore e kanë vendosur në mesin e grave më të shquara të botës duke u përfshirë në "The International Eho's Eho of öomen" të Europa Publications Limited (Londër, 1992) si dhe në vëllimin "Eho's Eho Professional and business öomen" të Institutit Amerikan të biografive (SHBA, 1993). Është njohëse e shtatë gjuhëve të huaja.

Qyteti im: Një rrugë në qytetin e Korçës do të ketë emrin tuaj. Çfarë ndjesie përjetuat pasi mësuat vendimin e Këshillit Bashkiak ?

Andromaqi Gjergji: Vlerësimi që më bëri Bashkia Korçë, zgjoi tek unë një mori ndjenjash e përshtypjesh e sidomos një ndjenjë kënaqësie e mirënjohjeje, sepse gjithnjë e kam ndjerë veten të lidhur me qytetin tim të lindjes me mijëra fije, të dukshme e të padukshme. Jam krenare që jam korçare dhe me kalimin e viteve kjo ndjenjë ka ardhur duke u forcuar. Korça dhe rrethinat i saj, kanë zenë vend në shumë shkrime të miat dhe pse studimet e mia janë shtrirë në shumë krahina të atdheut.

Qyteti im: Gjatë një jete të tërë me shkencën studimet tuaja prekin shumë fusha dhe kanë patur një shtrirje të madhe gjeografike. Por vërej se botimi juaj i parë në fushën e etnografisë (1952) përqëndrohet tek Opari il Korçës. Është kjo një fillësë rastësore?

Andromaqi Gjergji: Gjatë viteve të mia të punës në Sektorin e Etnografisë, për vite me radhë jam marrë me krijimin e koleksioneve për Muzeun Etnografik të Tiranës, duke mbledhur materiale në terren dhe duke mbledhur informacionin e duhur. Për këtë kam qenë pjesë e ekspeditave të shumta në krahina të afërta e të largëta, në pazaret e qyteteve etj. Në këtë kuadër, një grup i vogël me punonjës shkencorë të Muzeut, kryem një ekspeditë në zonën e Opari, ku arritëm të mbledhim materiale me vlerë sidomos mbi mjeshtrat që ndërtonin banesa dhe mbi sharrëxhinjtë, si dhe mbi veshjet popullore e mbi festat popullore.

Qyteti im: Në studimet tuaja veç të tjerash ju keni dhënë një pamje të përgjithshme mbi ndryshimin që pësoi përdorimi i veshjes nga popullore apo kombëtare e përdorur në fshat dhe qytet në veshjet civile apo allaeuropiane si c'filluan të quheshin në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ju shkruani se vendin e parë për këtë ndryshim e zë Korça.

Andromaqi Gjergji: Për veshjet popullore kam botuar një varg artikujsh e studimesh, duke marrë në shqyrtim shumë aspekte të zhvillimit të tyre. Në përpjekje për të ndjekur zhvillimin historik të tyre, nga Shek. XIII në Shek. X, kam shfrytëzuar shumë dokumente arkivore, botime veprash të tre-katër shekujve të fundit, shpesh herë të ilustruara me skica e gravura të kohës dhe nga mesi i Shek. XIX e këtej edhe me fotografi. Nga njohja e këtyre burimeve si dhe nga njohja e veshjeve të ruajtura në koleksionet e muzeve kryesore të vendit, në përgjigje të pyetjes suaj mund të them se në Korçë veshja "alla frënga", në dallim nga veshjet e mëparshme "alla turka" kanë hyrë në përdorim me shpejtësi në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX, si për gratë edhe për burrat. Ato hyjnë si një ndikim i modës europiane të kohës dhe kishin padyshim një lidhje të drejtpërdrejtë me dëshirat e aspiratat e rilindasve tanë të ndritur, për t'u shkëputur nga pushtimi turk. Nëpër shtëpitë korçare, ka ende fotografi të shumta familjare të kësaj kohe, që dëshmojnë më së miri për këto ndryshime. Këto ndryshime nuk ishin një fenomen i shkëputur, por lidheshin me shumë ndryshime të tjera që prekin mënyrën e jetesës dhe anë të tjera të jetës shoqërore. Edhe veshjet e fshatarësisë, ndryshe nga krahinat e tjera të Shqipërisë, ndryshuan shumë shpejt pas Luftës së Dytë Botërore, duke mënjeluar gradualisht veshjet popullore.

Qyteti im: Keni studiuar veshjen ,mënyrën e jetesës, të të ushqyerit, artin popullor. Në

cilën nga fushat e veprimtarisë suaj keni "derdhur" më shumë pasion ?

Andromaqi Gjergji: Për sa u përket veshjeve popullore, mund të them se kjo tematikë nuk ze më shumë se një të tretën e punimeve të mia. Kështu veç veshjeve, shumë artikuj e studime i kam kushtuar artit popullor fshatar të mjeshtrëve artistike, duke vënë në dukje arritjet më të mira të tyre, pastaj ndryshimeve të jetesës së fshatarësisë dhe sidomos ndryshimeve në jetën shoqërore gjatë proceseve të urbanizimit dhe në këto drejtime rrethi i Korçës ka pasur arritje të mira.

Qyteti im: Ju jeni një prej atyre njerëzve që keni punuar me përkushtim për mbledhjen, seleksionimin dhe ruajtjen muzeale të shumë vlerave të pasurisë sonë kombëtare. Si e vlerësoni gjendjen e muzeumeve shqiptare sot dhe si mund të mbi-jetojnë këto vlera në kushtet e reja të viteve të fundit?

Andromaqi Gjergji: Vitet e fundit, me zhvillimin e hovshëm të turizmit në Shqipëri, po gjallërohen një varg traditash kulturore, për të cilat shfaqin më shumë interes vizitorët e huaj, por tregu vendas, me sa duket nuk është i aftë të plotësojë këto kërkesa me cilësinë e duhur. Muze të etnografike të rretheve, nuk arrijnë t'i përballojnë si duhet kërkesat e kohës, me sa duket për mungesë fondesh financiare nga ana e shtetit. Mendoj se në këtë drejtim mund të kontribuojë më mirë tregu privat duke çelur herë mbas here galeri ose ekspozita të vogla, me shitje objektesh me vlera etnografike, si kanë filluar të veprojnë aty-këtu, dashamirës të pasionuar të këtyre vlerave në disa qytete e pika turistike të vendit.

Qyteti im: Jeni e para femër anëtare e Akademisë të Shkencave madje deri para dy muajsh keni qënë e vetmja. Mendoj se gratë shqiptare i kanë dhënë pak shkencës?

Andromaqi Gjergji: Në Shqipëri gratë që kanë punuar në fushën e kërkimit shkencor nuk janë të pakta, sidomos në disa fusha siç janë arkeologjia, etnologjia, historia e zhvillimit të arteve të zbatuara, muzeologjia, restaurimi i objekteve muzeale etj. Mesazhi im do të ishte që numri i tyre të rritet më tej dhe pjesëmarrja e grave në punë studimore shkencore të bëhet e njohur sa më mirë.



QYTETI IM - Vështrim në kohë

Vijon nga numri i kaluar

Në vitin 1914, populli i Korçës, zgjodhi si prefekt të qytetit patriotin e shquar, veprimtarin e dalluar të shoqërive patriotike në mërgim, sidomos në Rumani, veteranin Pandeli Evangjeli. Deri më sot kemi si informacion që është prefekti i parë i zgjedhur në qytetin tonë pas shpalljes së pavarësisë. Disa burime tregojnë se para tij ka qënë emëruar veprimtari dhe patrioti Lytfi Zavalani. Në bazë të këtyre dokumentave që zotërojmë, këtu fillon dhe historiku i prefekturës së Korçës. Pas tij, si prefekt i qytetit tonë u emërua Themistokli Gërmenji, i njohur në atë kohë me statusin e prefektit të policisë së republikës vetqeveritare të Korçës.

Pas mbledhjes në Lushnjë të Kongresit që mori emrin e këtij qyteti dhe formimit të qeverisë së re shqiptare me kryeqytet të ri të Shqipërisë Tiranën, Korçës i mbetej si detyrë e madhe që kufij të e saj të ishin nën territorin e shtetit shqiptar dhe qeverisë së kryesuar nga Sulejman bej Delvina.

Informatat e pakta që patriotët korçarë mundën të mbledhin në atë kohë, vërtetuan se së shpejti, një ushtri e madhe greke e komanduar nga gjeneral Trikupis do të grumbullohej në Follorinë dhe seriozisht do të pretendonte të zaptonte territorin e Korçës, menjëherë pas largimit të trupave franceze nga ky qytet. Patriotët u vunë menjëherë në korrent të ngjarjeve dhe organizuan një komitet që përbëhej nga baba Ramadan Qatromi, Pandeli Cale, Eshref Frashëri (Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Botore të qeverisë së Tiranës) dhe Tefik Panariti. Këta lajmëruan popullin e Korçës (më 24 maj 1920), që pas dy ditësh të këtij lajmërimi, të mblidhen në qendër të qytetit. Kështu më 26 maj 1920, korçarët dhe përfaqësuesit e tyre, të mbledhur para godinës së bashkisë së qytetit deklaruan bashkimin e këtij qyteti me qeverinë e Tiranës. Kryetari i Bashkisë së Korçës i asaj kohe, patrioti Sotir Kotta, valëviti në ballkonin e godinës së institucionit të tij flamurin kombëtar shqiptar.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

Shënim: Të dhënat historike dhe hipotezat e paraqitura në këtë artikull nuk prezantojnë një qëndrim zyrtar të stafit të gazetës.

Përgatiti: Niko Kotherja




Hilë Mosti nga Shkodra, ish - prefekt i Korçës.



Ismet Kryeziu nga Gjakova, prefekt i Korçës në vitet 1932.



Mark Kodheli, ish prefekt në Korçë.



Pandeli Evangjeli nga Korça, prefekt i Korçës në vitin 1914.



Rexhep Jella nga Tirana, prefekt i Korçës në vitet 1925, 19.



Sotir Kotta - kryetari i parë i bashkisë së Korçës, 1918.



Tereno Toçi nga Shkodra, ish - prefekt i Korçës.



Burime:

Librat:

- "Fjalori enciklopedik shqiptar", Tiranë, 1985
- "Korça, në faqet e historisë", Emin Selenica
- "Një faqe historike", Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- "Korça - urbanistika, arkitektura", Pirro Thomo
- "Mbi themelimin e Korçës" (broshurë) Arben Gjata
- "Shqipëria më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Shqipëria e ilustruar më 1928", Teki Selenica, Tiranë, 1928
- "Korça dhe fshatrat përfaqar", Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- "Korça dhe katundet e qarkut" (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- "Historia e Shqipërisë" vëll. II, Tiranë 1965
- "Themistokli Gërmenji", Pirro Tako, Tiranë, 1988

Gazetat:

- (Koleksione pranë Bibliotekës "Thimi Mitko" dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
- "Korça" drejtuar nga Sami Pojani e Lytfi Zavalani, Korçë, 1908-1910
- "Lidhja othodokse", drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
- "Koha" drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
- "E drejta", drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
- "Gazeta e Korçës", drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935

Monumente Kulture

Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit Histori dhe vlera

Xhamia e Iliaz Mirahorit është shpallur monument kulture në vitin 1948. Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit është ndërtimi më i vjetër që ekziston sot në qytetin e Korçës dhe që lidhet me fillimet e këtij qyteti.

Xhamia e Mirahorit ka volume dhe siluetë që shquhen për proporcionet e shkëlqyera.

Ajo është shembulli më i hershëm i tipit me një kupolë që u prezantua në territorin e Shqipërisë së sotme. Kupola në mënyrë qendrore, mbulon sallën e lutjeve që ka formën e një kubi. Në hyrjen ballore hapësira mbulohet nga një portik me tre kupola, të cilat mbështeten mbi katër kolona kuadratike të shëndosha.

Minarea, sikurse në të gjitha xhamitë e kësaj periudhe, ndodhet në qoshen e jashtme Veri-Perëndimore. Hyrja e minaresë është nga brenda, në një bazë ortogonale sikurse kanë qënë ato të Periudhës Selxhuke. Minarea u shkatërrua prej tërmetit të vitit 1961, së bashku me Kullën e Sahatit që ngrihej pranë saj në oborrin e xhamisë. Oborri i xhamisë është i ndërtuar më tepër si një kopsht se sa si një oborr faltoreje.

Në mbishkrimin që ndodhet mbi hyrjen e xhamisë përmendet se Iliaz Bej Mirahori themeloi këtë xhami në vitin 1495/96 (901 p.H.). Më pas përmendet Mehmet Beu, i cili e veshi me plumb në vitin 1572/73 (980 p.H.) dhe më tej përmendet dy riparime njeri i bërë prej Dervish Islam Beut, në vitin 1833/343 (1249 p.H.) dhe tjetri i bërë nga Sali Beu në vitin 1868/69 (1285 p.H.).

Punime më të mëdha për restaurimin e saj janë ndërmarrë në vitet 1974-78 nga Prof. Dr. Pirro Thomo. Këto konsistuan në konsolidimin statik të kupolës dhe riveshjen e saj tërësisht me plumb, pasi ai i vjetri (plumbi) ishte ndërtuar në mënyrë të pariparueshme. Gjithashtu u hoq me një kujdes të jashtëzakonshëm e gjithë suvaja e jashtme në të cilën ky monument ishte veshur në fund të shek.19-të dhe doli në pah teknika dhe dekoracioni i veçantë, që është një kombinim i blloqeve kuadratike prej shtufi dhe rreshta tullash, teknikë kjo mjaft e përhapur në periudhën e hershme të arkitekturës otomane.

Në vitin 1996, me rastin e 500 vjetorit të ndërtimit të këtij monumenti, Ateljeja e Korçës, (sot Drejtoria e Monumenteve të Kulturës) drejtoi punimet për resaturimin e brendshëm të xhamisë. Peisazhet dhe dekoracionet e shkëlqyera të shek. XVIII e XIX u restauruan me një kujdes, duke risjellë vlerat hapësinore dhe monumentale të saj.

Burimi: Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës





Pezullohet aktiviteti i njësive të shitjes së gazit të lëngshëm

Pas shpërthimi i një dyqani me bombola gazi në muajin gusht, Bashkia e Korçës veprroi menjëherë duke pezulluar aktivitetin e 10 pikave të tregëtimit të këtij gazi në qytet.

Me iniciativën e Kryetarit të Bashkisë Niko Peleshi, u ngrit një grupi i posaçëm Task Force me përbërje ndërinsticionale, i cili vlerësoi kushtet e sigurisë për sejcilën pikë dhe konstatoi se në asnjë rast nuk plotësoheshin kushtet teknike. Përballë këtij fakti, Bashkia Korçë pezulloi përkohësisht aktivitetin e këtyre njësive, deri në plotësimin e të gjitha kushteve teknike dhe standarteve ligjore.

Duke qenë pranë qendrave të banuara, poshtë pallateve dhe shumë afër lagjeve, këto pika mbartin një rrezik potencial për jetën njerëzore veçanërisht në kushtet kur këto pika ishin totalisht jashtë kontrollit të inspektoriatit teknik. Një nga kushtet teknike është edhe shpërngulja e këtyre njësive nga katat e para të pallateve. Për këtë iniciativë, në drejtim të ruajtjes së sigurisë qytetare, Kryebashkiaku Peleshi mori edhe një letër falenderimi nga Inspektoriat i Qëndror Teknik.



Në Zyrën e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Korçë filloi shpërndarja e çertifikatave elektronike

Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Korçë, duke filluar që në datën 16.09.2008, filloi dhënien e çertifikatave elektronike.

Procesi filloi në zbatim të Urdhërit Nr. 1109 të Ministrisë së Brendshme, i cili mban datën 11.09.2008 dhe që bën fjalë për "Miratimin e rregullores për lëshimin e çertifikatave në format elektronik dhe metodën e punës për funksionimin në të njëjtën kohë të regjistrit themeltar dhe regjistrit elektronik të të dhënave, nga zyrat e gjendjes civile në bashki dhe komuna".

Sipas këtij urdhëri, pas datës 15 shtator, në asnjë rast nuk do të lejohet shpërndarja e çertifikatave me shkrim dore.

Pranë Gjendjes Civile në Bashkinë Korçë, janë instaluar 6 kompjutera dhe 3 printera. Situata e re, pritet që të ketë ndikim pozitiv duke shpejtuar dhënien e çertifikatave si dhe do të ndikojë ndjeshëm në shmangien e rradhëve të gjata të qytetarëve pranë sporteleve të kësaj zyre.

Njëkohësisht, është menduar më tepër edhe për komoditetin e qytetarëve por edhe të punonjësve të kësaj zyre. Kështu shumë shpejt, me një fond prej 2,7 milion lekësh, do të bëhet zgjerimi dhe mobilimi i ambjenteve. Do të krijohet një holl i përshtatshëm për qytetarët më stola për çlodhje, si dhe do të zgjerohet ambienti i punës. Në këtë mënyrë qytetarëve do t'u krijohen kushte më dinjitoze si në ambientet e pritjes ashtu edhe gjatë shërbimit.



Koncert vokal - instrumental

Në sallën e koncerteve të Qendrës Kulturore "V.Mio", trioja Shirli Polena - soprano, Adrian Xhema - tenor dhe Kristina Laço në piano, dhanë një koncert vokal-instrumental.

Koncerti i mbështetur nga Bashkia Korçë dhe Qendra Kulturore "V.Mio" u organizua në kuadër të sezonit koncertor të muzikës dhe mund të konsiderohet ndër më të rëndësishmit për shkak të emrave të spikatur që morën pjesë në të. Krahas sopranos së mirënjohur korçare Shirli Polena, pianistes Kristina Laço, aktualisht Pedagogje në Akademinë e Arteve, për herë të parë vjen në Korçë tenori po kaq i mirënjohur Adrian Xhema, me një karrierë mjaft të suksesshme brenda e jashtë vendit, fitues i disa çmimeve kombëtare e ndërkombëtare. Xhema është aktualisht solist pranë Operas së Mynihut në Gjermani.

Në koncertin e dhënë për artdashësit korçarë, Xhema e Polena dalluan për vokalin e tyre të spikatur, forcën interpretative si dhe repertorin e pasur.

Në repertorin e artistëve bënë pjesë vepra të klasikëve më të mëdhenj botërorë Schubert, Puccini, Mozart etj, të cilat u interpretuan herë solo e herë duet të shoqëruar nga pianistja Kristina Laço.

Koncerti u ndoq nga një numër i madh artdashësish korçarë.



Koncert nga Dixie Band "Saint Maria" i qytetit të Korçës

Koncerti i Dixie Band "Saint Maria" i qytetit të Korçës, nën drejtimin e Josif Mingës u dhuroi një mbrëmje të veçantë artdashësve në sallën e Koncerteve pranë Qendrës Kulturore "V.Mio". Në programin e koncertit bënë pjesë ndër të tjera, një kolazh muzikor me katër këngë korçare të përpunuara me frymën e jazz-it, si dhe këngët më të njohura të muzikës jazz dhe krijuesve të saj, Amstrong e Fitzgerald. Këngët korçare të sjella ndryshe nga 8 orkestrantë të "Dixie Band" si dhe ritmi i jazz-it, është diçka që i ka munguar qytetit. Ato u duartrokitën nga publiku i pranishëm në sallë.



Ekspozitë pikturë

Në datat 13 deri 20 shtator, përgjatë një jave, në Galerinë e arteve "Guri Madhi" qëndroi e hapur ekspozita me piktura nga Çlirim Çollaku. Cikli i pikturave të ekspozuara është titulluar nga autori "Free Art". Janë

40 piktura të madhësive të vogla dhe të mesme në gjininë e artit abstraksionist, të punuara në teknikën e akrelikut. Kjo është ekspozita e parë e piktorit në qytetin e Korçës pas viteve '90.

Çlirim Çollaku është një piktor me përvojë të gjatë. Ai është duke e ushtruar aktualisht artin e tij në dy shtete, Shqipëri dhe Gjermani.

Ekspozita u mundësua nga Bashkia Korçë dhe Qendra Kulturore "V.Mio"



Përkujtohet Manifestimi Antifashist i 9 shtatorit të vitit 1943

Manifestimi Antifashist i 9 shtatorit të vitit 1943 ka hyrë në historinë tonë, si manifestimi paqësor më i përgjakshëm në historinë e luftës.

Ky memorial është simbol i përpjekjeve të shumta të qytetarëve të Korçës për liri, pavarësi dhe identitetin kombëtar. Me këtë rast, kurora e buqeta me lule u vendosën nga Bashkia Korçë, Prefektura, Këshilli i Qarkut, shoqatat e veteranëve të luftës e familjarë.

Të pranishmit i përshëndeti edhe Nënkrjetari i Bashkisë së Korçës, Arjan Bejko.



Ambasadori i ri i Greqisë Nikos Pazios bën vizitën e parë në Korçë

Ambasadori Grek në Tiranë Nikos Pazios zhvilloi një vizitë zyrtare në Bashkinë e Korçës ku u prit nga Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi dhe stafi i tij. Ambasadori i ri i Republikës së Greqisë në Shqipëri Nikos Pazios, ka preferuar ta fillojë nga Korça turin e vizitave të tij zyrtare nëpër Shqipëri. Kryebashkiaku Peleshi e uroi ambasadorin grek për detyrën e re, duke shprehur në një intensifikim të ri të marrëdhënieve me partnerët grekë. Nga kjo tryezë, Pazios garanoi se do të përm-bushë me përkushtim detyrën e tij në Shqipëri, në shërbim të thellimit të bashkëpunimit të frytshëm dypalësh mes dy vendeve dhe popujve tanë. Ai theksoi se kjo vjen jo vetëm si rezultat i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis dy vendeve, por se Greqia e shikon Shqipërinë si një vend partner të rëndësishëm në konfigurimin rajonal. Pazios e Peleshi u angazhuan për të punuar në fusha me interes të ndërsjelltë.



Futboll, tashmë Skënderbeu një ekip që premtton shumë



Ngjallen shpresat në rradhët e ekipit të futbollit "Skënderbeu" për ta ngjitur atë në nivelet më të larta. Kjo frymë optimizmi erdhi për skuadrën pas rikthimit në të, të Bledi Shkëmbit, futbollistit më të kërkuar të markatos shqiptare të këtij viti. Shkëmbi vjen në skuadrën korçare pas një eksperience disavjeçare me ekipin kombëtar. Ardhja e tij u vlerësua mjaft edhe nga Kryebashkiaku i Korçës Niko Peleshi. Duke i rezervuar një pritje të veçantë në Bashki, pas firmosjes së kontratës, Kryetari i Bashkisë Peleshi, tashmë edhe me cilësinë e Presidentit të Klubit, i dorëzoi Shkëmbit simbolikisht, fanellën e kapitenit të skuadrës, duke e falenderuar për përgjegjësinë qytetare për të kontribuar për Klubin e Futbollit Skënderbeu. Pas përfshirjes së mjaft lojtarëve cilësorë, nën drejtimin e Trajnerit Renato Rrapo me Drejtor Ekzekutiv Gjergji Ballço, objektivi kryesor për këtë skuadër mbetet, dalja kampion dhe hyrja në Ligën Superiore.

Vendime

Disa nga vendimet më të rëndësishme të Këshillit Bashkiak

Datë 19.09.2008

- 1.Për vënien e emrit të personalitetit të mjekësisë shqiptare Dr. Selaudin Qemal Mborja, Poliklinikës së qytetit Korçë
- 2.Për strehimin me prioritet të familjeve që banojnë në mjediset e ish repartit 741
- 3.Për strehimin me prioritet të familjeve që banojnë në mjediset pranë Shkollës "Sotir Gurra"
- 4.Për dhënien në huapërdorje të sip. Prej 98 m2 të ndodhur në Pallatin e Sportit "Tamara Nikolla"
- 5.Miratim i strukturës së punonjësve të konvikteve të sistemit asimor parauniversitar
- 6.Për një shtesë në përcaktimin e Prioriteteve të Investimeve për vitin 2008
- 7.Për dhënien me qira me Emfiteozë të sip. 22670 m2 të UIK sh.a
- 8.Për shërbimin e internetit falas në tre shkollat e mesme të qytetit
- 9.Mbi emërtimin e disa rrugëve në qytet

Të nderuar qytetarë!

Në rast se dëshironi të keni vendimet e plota të Këshillit Bashkiak, mund t'i merrni tek Zyra e Protokoll-Arkivës në Bashki, çdo ditë nga ora 12.00 deri në orën 14.00

Korça ku → dua të jetoj

Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë,
kjo është mundësia jote.
Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh
krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga
ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë
tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta
shihni.

Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen
në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju
do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj
në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjid-
het fotoja e vitit.

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe
një përshkrim të shkurtër të fotos
dhe pse e keni zgjedhur
pikërisht atë.

Fotoja e muajit: **Arkitekturë
moderne**

Autori: **Vasjan Golka**

**“Arkitektura moderne e bën
qytetin të ecë me kohën”**



Problematika me syrin e qytetarëve

Qytetarët japin mendimin e tyre në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje

Nuk jam dakord me mendimin që Korça të vazhdojë të shtrohet me kalldrëm. Ata që e duan akoma këtë qytet me kalldrëm, duke pretenduar se Korça është qytet antik, janë me mentalitet arkaik. Antike janë Berati apo Gjirokastra dhe jo Korça. Korça është quajtur “Parisi i vogël” pikërisht për civilizimin europian dhe sharmin që ka. I propozoj Bashkisë të heqë dorë nga ky koncept.

Gjatë dy tre viteve të fundit dhe veçanërisht gjatë këtij viti është punuar shumë me gjelbërimin. Të bien në sy lulishtet e reja të krijuara si ato mes pallateve. Por kam frikë se ajo mund të degradojë si disa lulishte të tjera nga dëmtimet e personave të pandërgjegjshëm, sidomos nga fëmijët. Ndaj mendoj se duhen vendosur roje.

Korça është shtrirë shumë, ndërkohë që urbani kalon vetëm në stacionet e caktuara para disa vitesh. Po kështu është e nevojshme edhe zgjatja e orarit të shërbimit urban gjatë ditës, pasi është shumë i kufizuar dhe nuk i plotëson nevojat tona.

Në Pazar, vendosja e çmimeve dhe kontrolli i peshave le për të dëshiruar. Ka raste të shpeshta të abuzimeve me qytetarin. Në rast se kërkoni ndihmën tonë për të bërë denoncime konkrete, ne jemi në dispozicion.

Jam pro shtrimit të rrugicave me kalldrëm të qytetit. Rrugicat me kalldrëm janë veçantia e qytetit. Ato së bashku me kangjellat dhe bashtat

me trendafila janë veçantia e qytetit me të cilat ne jemi mburur deri më sot pavarësisht se dikush i quan arkaike. Korça nuk është as Fier e as Durrës apo ndonjë qytet tjetër, ndaj t’i ruajmë ato vlera që kemi.

Mbështes iniciativën e Bashkisë që edhe ne të kontribuojmë financiarisht për ndërtimin e lulishteve mes pallateve. Kjo me siguri do të rritë edhe më shumë përgjegjësinë tonë për t’i mirëmbajtur ato.

Ngritja e një pallati në vit nuk është aspak e mjaftueshme për ta zbutur këtë fenomen. Ndaj mendoj se pushteti vendor duhet të këmbëngulë më shumë tek qeveria për të tërhequr më tepër fonde. Mendoj gjithashtu se Korçës si qytet me trashëgimi historike, i mungon një muze etnografik, pasi vlera të mëdha të kësaj trashëgimie qëndrojnë të fshehura.

Mungesa e koshave të vegjël në qytet, ndikon dhe e rëndon akoma më shumë ndotjen e ambientit. Vendosja sa më parë e tyre është një domosdoshmëri, pasi mbi të gjitha tregon qytetari.

Nuk ka kuptim asfaltimi i një rruge në mes të pallateve, e cila është e rrethuar nga dhjetra rrugë me baltë. Mendoj se në këtë mënyrë humbet investimi, ndaj mendoj se asfaltimi duhet bërë në blloqe pallatesh.



Fjalën

e ke ti!

Komplimenta **Komente** **Ankesa**

Bashkia të ofron mundësinë të thuash atë që ti mendon mbi shërbimet e ofruara prej saj, sa pranë nevojave tuaja qëndrojnë ato dhe çfarë do të donit të bëhej më mire!

Ju mund të dërgoni **KOMPLIMENTE**, **KOMENTE** apo **ANKESA**

Ne kemi marrë përsipër t' ju sigurojmë shërbime sa më cilësore. Për këtë na duhet mendimi juaj. Nëse kemi bërë një punë të mirë apo jo, ne duam ta dëgjojmë këtë nga ju.

Fjalën e ke ti!

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Dorëzoni formatin e plotësuar pranë Zyrës së Informacionit "Bashkia Korçë"

Jepni sa më shumë informacion

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Të dhënat tuaja (jo e detyrueshme)

Emër Mbiemër:
Profesioni:
Adresa:
Tel:
e-mail:

Zgjidhni opsionin

- Komplimenta**
 Komente
 Ankesa



Festa e lakrorit



Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori
Benila Tërova

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës "V.Mio"
Teatri "A.Z.Çajupi"

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Vaskë Niço
Foto "Xhimi"
Orieta Glozheni

Design:

R&T Advertising

Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realitojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një këthese ecim me vull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni "Qyteti Im"

Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@albmail.com

www.bashkiakorçe.gov.al

